



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 148, Datë, 10.09.2020

“MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E RREGULLORES MBI PROCEDURAT PËR DHËNIEN E SË DREJTËS SË PËRJASHTIMIT PËR INFRASTRUKTURËN E RE TË GAZIT NATYROR”.

Në mbështetje të nenit 16 dhe 32 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 38, nenit 43, pika 1 dhe nenit 78 të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 03.09.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, (ERE) në mbledhjen e tij të datës 10.09.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr.99/3 datë 03.09.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores mbi procedurat për dhënie të së drejtës së përjashtimit për infrastrukturën e re të gazit natyror,

Konstatohet se:

- Objektivi i kësaj rregullore është të sigurojë nxitjen e investimeve në infrastrukturën kryesore të re, duke garantuar funksionimin e tregut të gazit natyror.
- Qëllimi i kësaj rregullore është: Të përcaktojë rregullat për një procedurë përjashtimi transparente, jo diskriminuese dhe të arsyetuar në përputhje me rregullat e Paketës së tretë të energjisë.
- Procedura që aplikohen për përjashtimin në këtë Draft rregullore, janë bazuar në parashikimet e nenit 78 të ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

- Kjo Rregullore, paraqet rregulla për mënyrën e paraqitjes së kërkesës dhe procedura transparente për të shmangur çdo parregullësi për pasjen e një tregu transparent dhe konkurrues.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullores mbi procedurat për dhënien e së drejtës së përjashtimit për infrastrukturën e re të gazit natyror.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI